

Rrugë të reja legale për punë në Gjermani
për shtetasit e shteteve të „Ballkanit Perëndimor“
Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal i Zi dhe Serbi

Kontrolloni, ju lutemi, nëse jeni me të vërtetë person në nevojë për mbrojtje!
Faktikisht janë shumë më pak se 0,5% e të gjithë azilkërkuesve nga vendet e Ballkanit Perëndimor që fitojnë një status mbrojtjeje. Prandaj në pjesën më të madhe të rasteve do të ishte veprim i arsyeshëm, po ta tërhiqni kërkesën për azil.

Ai që pret deri sa t'i refuzohet kërkesa për azil, duhet të llogarisë se pas refuzimit do t'i ndalohet të hyjë për një kohë të gjatë në Gjermani dhe në të gjithë zonën e Shengenit. Veç kësaj atë e kërcënon kthimi me detyrim!

Me tërheqjen e kërkesës për azil mund të përfitoni eventualisht edhe nga lehtësimet e reja në të drejtën e qëndrimit në Gjermani:

Sepse prej 1 janarit 2016 e keni më të thjeshtë të punoni në Gjermani.

Po ta keni paraqitur kërkesën për azil pas 1 janarit 2015 dhe para 24 tetorit 2015 dhe largoheni tani sa më shpejt që të jetë e mundur vullnetarisht nga Gjermania, mund të vini sërish, po të keni gjetur një vend pune.

Në atdheun tuaj mund të paraqisni atëherë një kërkesë për leje qëndrimi në Gjermani (në Ambasadën Gjermane në vendin tuaj).

Kushtet që duhen plotësuar:

- Për këtë keni nevojë për një ofertë konkrete, detyruese për një vend pune nga një punëdhënës në Gjermani.
- Për vendin e lirë të punës nuk duhet të jetë në dispozicion askush nga Gjermania ose nga BE.
- Ju nuk lejohet të fitoni më pak para se një punëmarrës i krahasueshëm me ju.

Ju nuk duhet të keni kualifikime të veçanta. Nuk ka kufizim për profesione të caktuara.

Në kërkimin për një vend pune të përshtatshëm ju ndihmojnë:

- Zyra Qendrore për Ndërmjetësimin e fuqisë punëtore të huaj dhe të specializuar (ZAV) – Numër - Hotline: 0049 228 713-1313.
- Portali në internet i vendeve të punës i Agjensisë Federale të Punës: [<https://jobboerse.arbeitsagentur.de/>].

Ky rregull është në fuqi për një afat të kufizuar deri në vitin **2020**.